VENDIM
Nr.731, datë 23.11.2005

PËR LEJIMIN E ANTA SHA, TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË", PËR FONDIN E SHTUAR PËR PAGESËN E KONSULENTËVE JURIDIKË, TË PËRZGJEDHUR, PËR PËRFUNDIMIN E PËRGATITJES SË ANALIZËS JURIDIKE TË MBULIMIT TË GARANCISË POLITIKE TË RISKUT TË KREDISË QË DO TË MERRET NGA BNP PARIBAS BANK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË MODERNIZIMIT TË TRAFIKUT AJROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA) sh.a. që për fondin 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) USD, të llogaritur si 30 për qind e fondit limit prej 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) USD-sh, të përcaktuar në vendimin nr.462, datë 9.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" për plotësimin dhe përfundimin e analizës juridike të mbulimit të garancisë politike të riskut të kredisë, që do të merret nga BNP Paribas Bank, me katër konsulentët juridikë, si më poshtë vijon:

WEIL Gotshal&Manges LLP, në Nju Jork 120 000 USD;
Weil Gotshal&Manges LLP, në Bruksel 10 500 USD;
Studio Legale Tonucci, në Shqipëri 30 000 USD;
Thompson Couburn, në Uashington D.C. 4500 USD.

2. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e ANTA sh.a.

3. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha